



**Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly**

LEGJISLATURA V

**Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 53
Prishtinë, më 19.09.2016, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303**

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Jasmina Zhivković, Agim Çeku, Mufera Sinik, Agim Kikaj, Milka Vuletiq, Sasha Milosavljeviq, Çerim Bajrami dhe Danush Ademi.

Munguan: Fisnik Ismaili, Rustem Berisha, Slavko Simiq dhe Veton Berisha.

Në mbledhje morën pjesë: përfaqësues nga OSBE-ja Senad Karaahmetović, përfaqësuese e RTK-serbisht-Marija Stanojeviq, përfaqësuese e BIRN – Amire Qamili, përfaqësuesi i Sekretariatit të KKK - Zijush Ahmeti dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit – Celal Iliaz.

Stafi Mbështetës i Komisionit, Natasha Prica-Tishma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Jasmina Zhivković, kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky:

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur, më 10.8.2016;**
- 3. Shqyrtimi i Planit të punës së Komisionit për sesionin vjeshtor;**
- 4. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesja konstatoi se rendi i ditës u miratua, pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur, më 10. 8. 2016

Kryesuesja konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtura më 10.08.2016, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Planit të punës së Komisionit për sesionin vjeshtor

Kryesuesja- Theksoi se gjatë ushtrimit të punëve të përcaktuara, Komisioni në fushën e legjislacionit ka miratuar të gjitha ligjet dhe harmonizuar me standardet Evropiane dhe është në interes që të përcjellim nxjerrjen e ligjeve dhe ndikimi i tyre në mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të komuniteteve. Në këtë kontekst procesi i mbikëqyrjes së legjislacionit duhet të jetë i vazhdueshëm, i pa penguar meqë është në interes të përgjithshëm në fusha të ndryshme të jetës shoqërore dhe në dobi të të gjitha komuniteteve.

Sa i përket Planit të punës për vitin 2016, njëra nga kompetencat kryesore të Komisionit është mbikëqyrja e zbatimit të Ligjeve. Në periudhën e tretë, Komisioni do të vazhdojë me procesin e monitorimit të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, konkretisht neni 11. Propozoi që grupi punues në periudhën sa më të afërt të mbaj mbledhje me arsye të hartojë rekomandimet konkrete dhe të njëjtat të dorëzohen për shqyrtim në Komision. Në fund të muajit shtator, Komisioni do të procedojë raportin final për miratim në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Komisioni duhet të bëjë nismën për procedim të monitorimit të ligjeve me prioritet, Ligji për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligji për Financat e Pushtetit Lokal (mbikëqyrja e zbatimit të ligjit nga ana buxhetore).

Në kuadër të bashkëpunimit ndër-parlamentar, në përputhje me interesat e paraqitura në nivelin diplomatik Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ka realizuar vizitë zyrtare në Republikën e Kuvendit të Kroacisë, më pas ka dalë me informacion ku i njëjti është miratuar në Kryesi.

Si detyrë e veçantë, mbetet raportimi i ministrave lidhur me shqyrtimin e çështjeve të caktuara nga fusha e punës dhe përgjegjësitë të Komisionit:

Në kuadër të kësaj përgjegjësie, do të ftohen në takim ministri i MASHT-it dhe rektori i UP-së, që të raportojnë për pranimin e kandidatëve të komunitetit joshumicë në fakultetet publike, për vitin akademik 2016/2017.

Në aktivitete e Planit të punës, do të përfshihet identifikimi i datave për festat e komunitetit joshumicë. Me iniciativë të Veton Berisha, Komisioni do të procedojë kërkesën për plotësim dhe ndryshim të Ligjit për Festat Zyrtare, me propozim që data '24 Qershor', të njihet si Festë Memoriale për komunitetin egjiptianë.

Ishte e mendimit që Komisioni të mbajë takime çdo javë, me qëllim që të realizohen çështjet e përcaktuara sipas Planit të punës për vitin 2016.

Në këtë mbledhje, Komisioni për të Drejta dhe Interesa të Komuniteteve dhe Kthim, nxori këtë:

Përfundim

Komisioni, me disa ndryshime dhe plotësime, miratoi njëzëri Planin e punës për sesionin vjeshtor 2016.

4. Të ndryshme

Kryesuesja, hapi debat me qëllim që të dëgjohen zërat a anëtarëve të Komisionit lidhur me temat e ngritura nga mbledhja paraprake.

Qerim Bajrami- theksoi se duhet të jemi konstruktivë sa i përket promovimit të të drejtave të komuniteteve. Ai dha propozim që të iniciohet shtypja e revistave në gjuhën e komuniteteve joshumicë. Lidhur me këtë çështje propozoi që Komisioni i pavarur për media në bashkëpunim me zyrën për çështjen e komuniteteve pranë Zyrës së Kryeministrit, të parasheh që prej fondit për zhvillim të komuniteteve të sigurohen shpenzime buxhetore për publikimin dhe shtypjen mediale (revista apo buletin) në gjuhën e komunitetit boshnjak, ndërsa komunitetet tjera mund të dalin me kërkesë të veçantë.

Gjithashtu, kjo zyre duhet të parasheh ndarjen e veçantë buxhetore për publikimin e 12 revistave, në vit. Sipas informatave që ka, financimi i revistave për një muaj, përafërsisht do të kushton në vlerë prej 2-3 mijë euro.

Kryesuesja, ishte e mendimit që çështja e ngritur nga z. Qerim kërkon të procedohet në mënyrë të veçantë. Andaj propozoi që në afat të caktuar të kërkohej nga KDI- a të hartojë Raport lidhur me publikimin dhe financimin e revistave për komunitetin joshumicë. Pas marrjes së këtij raporti, Komisioni do të marrë vendim për procedimin e të njëjtës.

Agim Çeku: gjatë vizitës në Kroaci, kemi marrë përvojë të mirë, sidomos kur bëhet fjalë për funksionalizimin e Këshillit Kombëtar Nacional, me ç' rast kanë formuar këshilla për secilin komunitet, ku shtypja e revistave dhe buletineve financohen nga shteti. Kjo praktikë ende nuk është e zbatueshme te ne. Prandaj pajtohet që KDI-a, të bëjë një hulumtim me arsye që raporti të përfshijë të dhënat për publikimin e revistave në emër të secilit komunitet, e jo vetëm për një apo dy komunitete.

Agim Kikaj- theksoi se jemi të thirrur të veprojmë në përputhje të plotë me mandatin kushtetues dhe ligjor. Prandaj konsideron se Komisioni duhet të jetë më konstruktiv dhe më përgjegjës në kryerjen e detyrave të adresuara nga komuniteti joshumicë.

U ndërlidh me temën që u ngrit nga kolegu dhe tha se botimi i mediave elektronike nuk ka bazë ligjore si për përfaqësuesit e komunitetit shumicë, ashtu edhe të komunitetit pakicë. Kryesisht për shqyrtimin e çështjeve me karakter të kësaj natyre mund të kërkohej interpretim në Kuvend.

Sasha Milosavljeviq mendon se është e ndjeshme çështja e transmetim publike të RTK-së, në gjuhën e komuniteteve joshumicë, andaj pajtohet me propozimin e dhënë nga kryesuesja që këtë çështje të adresojmë në Institutin Demokratik të Kosovës me qëllim që të hartojnë hulumtim parlamentar dhe më pas Komisioni do të zhvillojë procedurat e mëtejme.

Milka Vuletiq plotësisht pajtohet me diskutimin e kolegut Agim Kikaj, se çështjet e ngritura kërkojnë bazë ligjore dhe në këtë drejtim duhet të jemi të kujdesshëm që të mos tejkalohen kompetencat tona.

Mufera Sinik nuk pajtohet me propozimin e kolegut që të fillohet iniciativa për shtypjen e revistave vetëm në gjuhën e një komuniteti nga se ky zërim paraqet ndarje etnike. Konsideron se ky Komision është i obliguar të përkrah përfaqësimin e njëjtë për të gjitha komunitetet.

Ajo u shpreh se nuk ka revista të shtypura në gjuhën e komuniteti joshumicë dhe kjo paraqet ngecje për integrohem në shoqërinë kosovare.

Në kuadër të ngritjes së vetëdijesimit për informim të komuniteteve jo shumicë ajo propozoi që Komisioni të dalë me rekomandim që shtypja e revistave të botohet në gjuhën e komuniteteve, dhe e njëjta të votohet në Kuvend.

Pas propozimeve të paraqitura, Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe kthim, nxori këtë:

Përfundim

Obligohet administrata për mbështetje të Komisionit, të drejtohet me shkresë KDI- së që të hartojnë hulumtim Parlamentar lidhur me procedurat e publikimin dhe shtypjes mediale në gjuhën e komuniteteve dhe sigurimi i shpenzime buxhetore për një vit.

Danush Ademi, ai konsideron se me Kushtetutë ua garantohet përfaqësim i barabartë komuniteteve joshumicë, ndërsa e njëjta nuk po zbatohet në praktikë.

Sa i përket RTK-së, transmeton program publik medial nga një orë në ditë për komunitetet e tjera shumicë, ndërsa për komunitetin ashkali vetëm 15 minuta në javë. Kjo dëshmon se disa komunitete i gëzojnë të drejtat e plota ndërsa anashkalohen të drejtat e një komuniteti.

Propozimi i tij ishte që në emër të Komisionit të drejtohem me shkresë RTK-së dhe Bordit të RTK-së me qëllim të sigurohet transmetim publik çdo ditë nga 15 minuta, për komunitetin ashkali. Këto të arritura do të jenë të dobishme sepse në mënyrë racionale do të realizohen objektivat e transmetimit të programeve elektronike për të gjitha komunitetet.

Kryesuesja, sa i përket temës për transmetim publik në programin e RTK-së, kërkoi nga z. Danushi, të përgatitë kërkesën në formë të detajuar lidhur me rritjen e minutazhit, 15 minuta çdo ditë në transmetimin e programeve për komunitetin Ashkali. Në mbledhjen e radhës, Komisioni do të shqyrtojë të njëjtën dhe më pas do ta procedohet në institucionet përkatëse.

Qerim Bajrami diskutoi se përmes përfaqësuesve të komunitetit boshnjak dhe turk janë zhvilluar bisedime zyrtare dhe janë proceduar kërkesa me shkrim në UPZ dhe në Ministrinë për Arsim, Shkencë dhe Teknologji, që në Universitetin “Ushkin Hoti” në Prizren të hapet dega ekonomike në gjuhën e boshnjake dhe turke, mirëpo që tre vjet kjo çështje nuk është finalizuar.

Me rastin e angazhimeve për zgjidhjen e këtij problemi, gjatë kontakteve tona, hasim në përpjekje për bartjen e përgjegjësisë nga UPZ në MASHT dhe Agjencinë për akreditim për arsye të mos realizimit të vendimit të Kuvendit, të nxjerrë disa muaj më parë.

Ai dha propozim konkret që sa më parë, në Universitetin “Ushkin Hoti” në Prizren të hapet drejtimi në fakultetin ekonomik në gjuhën boshnjake dhe turke në vitin akademik 2016/2017. Gjegjësisht të merren të gjitha veprimet e nevojshme për akreditim të këtij drejtimi.

Kryesuesja, konstatoi se anëtarët e Komisionit miratuan me shumicë të votave, propozimin e dhënë nga Qerim Bajrami.

Kryesuesja, si temë e fundit, do të diskutohet çështja lidhur me regjistrimin e kandidatëve nga komunitetit joshumicë në afatin e parë dhe të dytë në Universitetet, për vitin akademik 2016/17.

Danush Ademi, e informoi Komisionin se ka vërejtje në Udhëzimin administrativ nr. 09/2016 për aplikimin e vendeve të rezervuara për regjistrim të kandidatëve nga komunitetet joshumicë në institucionet publike të arsimit të lartë”, të datës 03.06.2016, i nënshkruar nga ministri i MASHT-it. Me këtë rast paraqet pakënaqësinë e tij lidhur me numrin e të regjistruarve që i përkasin komunitetit joshumicë në afatin e parë dhe të dytë, të vitit akademik 2016/2017.

Qerim Bajrami ishte i të njëjtit mendim që të kërkohet lista e regjistrimit të kandidatëve të pranuar në afatin e parë dhe të dytë, ku do të rishikohet mundësia të plotësohen vendet e lira me kandidatë të komuniteteve të tjera joshumicë, në afat të tretë.

Si kërkesë e tyre e përbashkët ishte që në mbledhjen e radhës të ftohet ministri z. Arsim Bajrami dhe rektori i UP-së z. Marjan Dema që të raportojnë për rrjedhat e regjistrimit të kandidatëve të komuniteteve, në vitin akademik 2016/2017, me mundësi të plotësohen vendet e lira me kandidatë të komuniteteve joshumicë.

Në bazë të diskutimeve, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, nxori këtë:

Përfundim

Obligohet administrata për mbështetje të Komisionit, që në takimin e radhës të ftojë ministrin e MASHT-it, Arsim Bajrami dhe rektorin e UP-së, z. Marjan Dema, me qëllim të marrjes së informatave lidhur me implementimin e Udhëzimit Administrativ nr. 09/2016 për aplikimin e masave afirmative dhe vendeve të rezervuara për regjistrim të kandidatëve nga komunitetet joshumicë në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë dhe informata të tjera lidhur me hapjen e afatit të tretë me mundësi që plotësohen vendet e lira me kandidatë të komuniteteve joshumicë, në vitin akademik 2016/2017.

Kryesuesja e njoftoi Komisionin se në mungesë të prezencës (në pushim mjekësor) për një periudhë të caktuar, në emër të saj, kompetencat, përgjegjësitë dhe aktivitetet tjera të Komisionit i bartë te zëvendësuesi i parë, Agim Çeku dhe zëvendëskryesuesja e dytë, Myfera Sinik.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetare e Komisionit,

Jasmina Zhivković